



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:054666

Datë: 13.09.2024

Numri i dokumentit: 06158961

KF.nr.555/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Allmakes Global Services” A.Sh., me numër unik identifikues 811168120, dhe me seli në Komoran, Komuna Glllogoc, të cilin e përfaqëson me autorizim Valdrin Behrami Avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti rivlerësim tatimor, vlera e kontestit e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Valdrin Behrami Avokat, dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 05.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Allmakes Global Services” A.Sh., me seli në Komoran, Komuna Glllogoc, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.53/2022, i datës 25.02.2022, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Allmakes Global Services” A.Sh., me seli në Komoran, Komuna Glllogoc, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 23.03.2022, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr.53/2022 i datës 25.02.2022 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe të anulohet vendimi nr.53/2020 i datës 25.02.2022 i të paditurës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor

kryesor përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë të gjitha parashtrimeve të cilat i kanë paraqitur në parashtrirat e dorëzuara. Ajo çka vlen të theksohet më së tepërmi se kontrata e huasë nuk paraqet kontratë për të cilën kërkohet forma e shkruar sipas LMD-së. Pra sipas rregullativës ligjore kontrata mbi huanë mund të lidhet edhe verbalisht pasi që kontrata mbi huanë nuk kategorizohet tek kontratat formale, edhe përkundër kësaj paditësi ka kryer këtë obligim ligjor duke nënshkruar kontratë me familjarët e tij e të cilët kanë në pronësi disa biznese dhe i vetmi obligim i cili nuk është përfunduar ka qenë mungesa e transferit bankar, shtuar fakti këtu se huadhënësit janë familjarët e tij dhe nuk është fare e nevojshme që këto mjete të realizohen në rrugë bankare. Vendimi i kundërshtuar paraqet zbatim të gabuar të ligjit të aplikueshëm (ligji i vjetër për ATK dhe procedurat përkatësisht neni 19 par 1 ku parashihet se vlerësimi tatimor që realizohet nga ATK për T/P duhet të jetë i bazuar në të gjitha faktet e prezantuara). Në këtë drejtim ka prezantuar kontratat e huas dhe fakti se nuk është realizuar huaja nëpërmjet transferit bankar nuk e konteston faktin se mjetet janë pranuar sipas kontratës së huas në vlerën e përcaktuar dhe se të njëjtat nuk paraqesin qarkullim të realizuar të tatim paguesit e që për rrjedhojë është dëshmuar mjaftueshëm se këto mjete janë realizuar nga kontrata e huas e jo nga të hyra tjera. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se konsiderojnë që standardi i kërkuar ligjor është plotësuar në mënyrë që gjykata të bie vendim aprovues në këtë proces gjyqësor. Gjykatës i ka kërkuar që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 25.07.2024, i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura të paditësit si të pa bazuar në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar, është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Tutje ka shtruar se pretendimet e paditësit lidhur me trajtimin e deponimeve bankare nuk janë të barazuara për faktin se gjatë kontrollit tatimor, paditësi ka ofruar disa kontrata të huas por këtyre kontratave iu kanë munguar elementet esenciale të tyre nëse i referohemi Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të ardhura të Korporatave parashihet *“Për këtë kategori të të ardhurave llogaritja e detyrimeve tatimore bëhet duke u bazuar në kontratën në mes të palëve e cila përcakton 3.1.1 Shuma e huasë, 3.1.2 Afatin e kthimit të huasë, 3.1.3 Pranimi-kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarive bankare, 3.1.4 Shkallën e interesit të huas duke u bazuar në vlerën e hapur të tregut, 3.2 Nëse nuk plotësohen kushtet e parapara në nënparagrafin, 3.1 të këtij neni, huaja për qëllime tatimore trajtohet e ardhur për pranuesin e saj”*.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditura e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 15.08.2024, ndërsa me parashtesën e datës 30.08.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padi/ankesa e paditësit në tërësi si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi nr.53/2020 i datës 25.02.2022.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 05.09.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi nr.53/2022 i datës 25.02.2022T, të dhënat për biznesin nga ARBK, gjendja e borxheve për paditësin e datës 29.03.2022, Raporti i Kontrollit i datës 15.12.2021, Ankesë e paditësit në ATK datës 26.01.2022, Kontratë mbi huanë datës 28.11.2017, Deklaratë e datës 22.03.2021, Kontratë mbi huanë datës 10.11.2017, Kontratë mbi huanë datës 03.04.2017, Kontratë e datës 28.10.2017 dhe gjendja e llogarisë bankare për paditësin për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në shqyrtim gjyqësor, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ, deklarimeve në padi, shkresat e lëndë aktvendimit kontestues. Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi pas pranimit të Raportit të kontrollit ka parashtruar ankesë, pran Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës me datë 26.01.2022, për të cilën ankesë me datë 25.02.2022 Departamenti i Ankesave i ATK-së ka marr vendimin nr.53/2020 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin vendim ka refuzuar si të pabazuar ankesën e subjektit tatimor këtu paditësit, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë i ka lënë në fuqi, e kundër të cilit akt paditësi me këtë padi, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ në Gjykatë.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave - të ATK-së, me vendimin kontestues nr.53/2022 të datës 25.02.2022 e ka refuzuar

ankesën e të paditurit, ndërsa njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë i ka lënë në fuqi me arsyetim se kontestin e tatimpaguesit për trajtimin si të hyra nga ana e kontrollit, të huazimeve nga familjarët dhe persona fizik për të cilat janë prezantuar kontratat e huazimit dhe i cili trajtim sipas ankesës së tatimpaguesit nuk është i drejtë, pas analizimit të dosjes së tatimpaguesit konstaton se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit. Divizioni i Ankesave ka vërtetuar se kontrolli ka vlerësuar për lëvizjen e parasë duke marr parasysh të gjitha huazimet në mungesë të vërtetimit të prejardhjes së tyre nga tatimpaguesi. Prandaj kontrolli ka vlerësuar tatimpaguesin bazuar në nenin 7 Njohja e të ardhurave të tatueshme, të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për Zbatimin e Ligjit nr.05/L-029 për Tatimin në të Ardhura të Korporatave kur paragrafi 3 parasheh, *“E ardhur nga interesi në huadhënie konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huas të mjeteve monetare apo mjeteve të ngjashme me to”*. Po ashtu DA bazuar në kontratat e sjella nga tatimpaguesi ka konstatuar se të gjitha kontratat e prezantuar nga tatimpaguesi, nuk plotësojnë të gjitha kriteret e parapara të dispozitës së lartcekur-nuk është respektuar, pranimitimi i huas pasi që duhet të bëhet përmes llogarisë bankare, andaj në mungesë të plotësimit të kushteve të parapara në nenin paragrafin 1.1 të këtij neni vërteton se kontrolli ka vlerësuar me të drejtë.

Gjykata pretendimin e paditësit se vendimi i nxjerr nga Administrata Tatimore Kosovës është vendimi i kundërligjshëm dhe pa bazë ligjore, e vlerëson si të pa bazuar, sepse gjykata pas analizimit të të gjitha fakteve të prezantuara ka vërtetuar se vendimi kontestues është i drejtë dhe i ligjshëm, për arsye se kontratat e sjella nga tatimpaguesi këtu paditësi nuk i plotësojnë kriteret e parapara sipas dispozitave të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për Zbatimin e Ligjit nr.05/L-029, neni 7, Njohja e të Ardhurave të Tatueshme, paragrafi 3.1.3 ku parashihet *“Pranimi kthimi i huas duhet të bëhet përmes llogarisë bankare”*. Andaj në rastin konkret nuk është respektuar pranimitimi i huas pasi që duhet të bëhet përmes llogarisë bankare, rrjedhimisht në mungesë të plotësimit të kushteve të parapara në këtë nen, vërtetohet se kontrolli ka vlerësuar me të drejtë.

Pretendimi i paditësit se vendimi i atakuar nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë ligjore, dhe se vendimi i marr nga Administrata Tatimore e Kosovës, paraqet shkelje të dispozitave materiale dhe atyre procedurale, gjykata e vlerësoj si të pabazuar, ngase përveç të theksuarit në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parashihet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë*

prova me të cilat konstatohen faktet e tilla". Nga këto dispozita Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Tutje edhe sipas nenit 38 par. 2 të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtoj faktet në të cilat mbështetet kërkesa e saj. Esenca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se Gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga palët ndërgjyqëse, dhe tanimë është e qartë se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor u takon palëve.

Duke marrë për bazë faktin se gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar - administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative në vështrim të nenit 43 paragrafi 1, të LKA-se, nga provat e administruara në këtë kontest tregtar - administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur, kjo për faktin se paditësi në këtë kontest tregtar-administrativ ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se paditësi as në këtë kontest tregtar-administrativ nuk ka arritur që të paraqes fakte mbi të cilat e mbështet kërkesën e tij, dhe sipas nenit 319.1 të LPK-së përcaktohet se "*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*". Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike gjykata vlerëson se vendimi nr.53/2022, i datës 25.02.2022 i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi për shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të neni 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.555/22 datë 05.09.2024

Gj y q t a r j a
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.